

Prishtinë, 15 mars 2007

## **Kërkesa e KEK SH.A për Tarifat me pakicë**

### ***Përshkrimi i përgjithshëm i vendimit***

#### **1 Hyrje**

Ky shënim është i përgatitur si një përshkrim i përgjithshëm i vendimit të Bordit të ZRrE-së për tarifatat me pakicë, të propozuara nga KEK Sh.A në aplikacionin e tyre, të parashtruar në ZRrE, me datën 19 shkurt 2007.

#### **2 Shqyrtimi i kërkesës**

Gjatë shqyrtimit të kërkesës, ZRrE-ja ka qenë e interesuar të sigurojë që:

- Të ardhurat e mbledhura nga biznesi i Furnizimit Publik të KEK Sh.A sipas tarifave të propozuara, e duke pasur parasysh datën e propozuar të hyrjes së tyre në fuqi (1 prill 2007) dhe vazhdimi i tarifave ekzistuese gjerë me këtë datë, nuk do t'i tejkalojë tarifatat e aprovuara (të Ardhurat e Lejuara) nga Bordi i ZRrE-së, përkatësisht vendimi i datës 21 dhjetor 2006.
- Rritja e tarifave për kategorinë e konsumatorëve individual të mos jetë e ndjeshme. Sipas Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë, kërkohet nga ZRrE-ja, të sigurojë që tarifatat të paraqesin kostot reale (reflektive) dhe të mos përfshijnë ndërsubvencione ndërmjet kategorive të konsumatorëve. Megjithatë, ZRrE-ja duhet gjithashtu të marrë parasysh edhe detyrat e tjera të saja, e veçmas atë të mbrojtjes së konsumatorëve. Në pajtim me këtë, ZRrE-ja ka vendosur që asnjë kategori e konsumatorëve nuk do të pëson ndryshime që tejkalojnë 10% të tarifave mesatare (për konsumatorët shtëpiak edhe më pak), në mënyrë që t'iu shmangemi ngritjeve të çmimeve me hop (price shocks) dhe të sigurohet një kalim gradual në nivelin e tarifave, të kostove reale (reflektive). ZRrE-ja është gjithashtu e interesuar që pagesa për energji elektrike të jetë e përbalueshme për familjet me të hyra të ulëta, e të cilat momentalisht përfitojnë nga blloku tarifor nën <800kWh/muaj dhe nuk i plotësojnë kushtet për ndihmë, ashtu siç definohet për “rastet sociale”.

Shqyrtimi nga ana e ZRrE-së e aplikacionit të KEK SH.A, ka konfirmuar se tarifatat e propozuara janë në pajtueshmëri me të ardhurat e lejuara dhe të miratuara, dhe se ndryshimi në tarifatat mesatare për secilën kategori të konsumatorëve (duke i trajtuar të gjithë konsumatorët shtëpiak si një kategori të vetme) mbetet brenda udhëzimeve të vendosura nga ZRrE-ja. Këto ndryshime shihen më poshtë në tabelën 1, ku krahasohen të ardhurat mesatare aktuale të secilës kategori të konsumatorëve për vitin 2006, me ato të parashikuara për vitin 2007 (duke pranuar se tarifatat e reja me pakicë do të hyjnë në fuqi prej datës 1 prill 2007 dhe tarifatat e mëparshme do të zbatohen deri në atë datë).

**Tabela 1: Ndryshimet në tarifatat mesatare sipas aplikacionit të KEK Sh.A**

**Tarifatat mesatare**

Kërkesa e tarifave me pakicë e KEK Sh.A (me grupe)

Modifikuar nga ZRRE-ja më 8 mars 2007

Mesataret për vitin 2007 (tarifat e reja hyjnë në fuqi nga data 1 prill 2007)

Grupi tarifor	Tensioni I Furnizimit	Tarifa mesatare		
		2006 (aktuale) €c / kWh	2007 (parashikuar)a €c / kWh	Ndryshimi
0	110kV	3.62	3.36	-7.2%
1	35kV	4.34	4.71	8.4%
2	10kV	5.16	5.57	8.0%
3	0.4kV Kategoria I (konsumatorët me shpenzime të fuqisë reaktive)	5.81	6.35	9.2%
4	0.4kV Kategoria II	8.14	8.61	5.8%
5-6	Konsumatorët shtëpiak me matës	<b>4.34</b>	<b>4.58</b>	<b>5.4%</b>
7	Konsumatorët shtëpiak pa matës	5.06	4.76	-5.9%
<b>Të gjithë konsumatorët shtëpiak</b>		<b>4.38</b>	<b>4.59</b>	<b>4.7%</b>
8	Ndriçimi publik	7.35	7.50	1.9%
<b>Çmimi mesatar për të gjithë konsumatorët</b>		<b>4.92</b>	<b>5.14</b>	<b>4.5%</b>

a) mesatarja për 1 janar – 31 dhjetor 2007, duke pasur parasysh se tarifatat ekzistuese do të aplikohen gjer më 31 mars 2007 kurse tarifatat e reja do të fillojnë prej 1 prill 2007.

Sidoqoftë, ZRRE-ja është e brengosur në lidhje me dy aspekte të tarifave të propozuara:

- Heqja e grupit ekzistues dy tarifor për konsumatorët shtëpiak, e propozuar nga KEK Sh.A, do të çonte kah reduktimi i kostove (reale) reflektive dhe mund të rezultojë në rritjen e pikut të ngarkesave, gjë që çon në ngritjen e kostos së furnizimit për shkak të nevojës për t'i rritur importet e energjisë elektrike, në mënyrë që të barazohen këto ngarkesa. Kjo gjithashtu do të ketë ndikim të kundërt në përballeshmërinë e pagesës, duke eliminuar mundësinë që konsumatorët shtëpiak me të hyra të ulëta të zvogëlojnë faturat e energjisë elektrike duke zhvendosur konsumin e tyre në periudha kohore jashtë pikut të ngarkesave.
- Propozimi i KEK Sh.A, për heqje të rregullimit të tanishëm tarifave dy vlerëshe për konsumatorët shtëpiak do të çonte në një rritje shumë të madhe të tarifave, veçmas për konsumatorët me një nivel shpenzimi të ulët (të cilët edhe më se shpeshti janë edhe konsumatorët me të hyra më të vogla). Kjo shton shqetësimin lidhur me përballeshmërinë e pagesës.
- Këto janë ilustruar më poshtë në tabelën 2, ku janë krahasuar tarifatat mesatare të vitit 2006 për konsumatorët tipik shtëpiak, me ato të cilat do të zbatoheshin nëse tarifatat e reja do të ishin të aplikuara për tërë vitin 2007.<sup>1</sup>

<sup>1</sup> Krahasimi i një viti të plotë shfrytëzohet për të treguar më mirë ndikimet afatgjate të tarifave të propozuara, duke injoruar shtrembërimin që rezulton nga tarifetat e reja të propozuara, të cilat nuk hyjnë në fuqi gjerë më 1 prill 2007.

**Tabela 2: Ndryshimet në tarifatat mesatare të konsumatorëve shtëpiak sipas kërkesës së KEK Sh.A**

0.4kV Konsumatorët shtëpiak (tarifa dy-vlerëshe)		Konsumimi mujor kWh	Tarifat e tanishme		Kërkesa e KEK Sh.A (Viti i plotë)		
			Fatura vjetore €	Çmimi mesatar €/kWh	Fatura vjetore €	Çmimi mesatar €/kWh	Ndryshimi
0.4 kV Shtëpiak	Nevojat minimale (pa ngrohje)	200	93	3.85	132	5.52	43.2%
	Nevojat minimale (me ngrohje)	600	278	3.85	245	5.10	32.4%
	Konsumator mesatar	1,000	509	4.24	582	4.85	14.5%
	Konsumator i madh	2,000	1,202	5.01	1,145	4.77	-4.8%

Rritjet në tarifatat mesatare për konsumatorët më të vegjël shtëpiak do të paraqesin ngritje të mëdha krahasuar me tarifatat mesatare të përparme, gjersa konsumatorët më të mëdhenj shtëpiak do të vërejnë se tarifatat e tyre do të zvogëlohen. Kjo është në përputhje me kalimin e planifikuar për një tarifë shtëpiake të vetme, duke eliminuar ndërsubvencionimin e tanishëm prej konsumatorëve shtëpiak të mëdhenj në të vegjël që ekziston përmes shfrytëzimit të blloqeve me çmim të ndryshëm prej <800kWh/muaj dhe >800kWh/muaj.

Përgjigjet e propozuara të ZRrE-së për secilën nga këto çështje janë të paraqitura më poshtë.

### 3 Propozimet e ZRrE-së

#### 3.1 Tarifa me dy-vlera (tarifa e lartë dhe tarifa e ultë ditore) e konsumatorëve shtëpiak

ZRrE-së i ka shfaqur KEK SH.A. ngurrimin e vet për të eliminuar tarifën me dy vlerëshe (tarifa e lartë dhe tarifa e ultë) për konsumatorët shtëpiak, para gjithash, duke parë rëndësinë që ka në Kosovë, dhënia e sinjaleve të përshtatshme nëpërmjet të çmimeve për konsumatorët shtëpiak për të zhvendosur konsumin e tyre prej pikut në periudha kohore jashtë pikut. në mënyrë që të përmirësohet menaxhimi i ngarkesës. ZRrE-ja gjithashtu konsideron se përdorimi i tarifës me dy vlera për konsumatorët shtëpiak me të hyra të ulëta jep një mënyrë tjetër të përballeshmërisë së pagesës së energjisë, duke zhvendosur konsumin jashtë pikut të ngarkesave.

Sidoqoftë, ZRrE-ja i pranon brengat e KEK Sh.A të ngritura në aplikacionin e tij lidhur me rrezikun e shtuar për keqpërdorim (abuzim) të matësve ekzistues, për tarifë me dy vlera. ***Prandaj ZRrE-ja propozon të lejojë një përjashtim (derogim) të përkohshëm për zbatimin e tarifës me dy vlera, derisa matësit e tillë të përmirësohen dhe bëhen më të sigurt.*** Tarifa me një vlerë rezultuese do të harmonizohet për të gjithë konsumatorët shtëpiakë që kanë matës dy-vlerësh dhe një-vlerësh në mënyrë që të gjithë konsumatorët shtëpiak të paguajnë tarifë të njëjtë.

Kjo nuk duhet të konsiderohet si kufizim për ZRrE-në, tani apo në të ardhmen të këmbëngulë që të vazhdojë të zbatohet tarifa me dy vlera për konsumatorët shtëpiak, por as ta kufizojë KEK Sh.A të aplikojë për të kaluar në një tarifë të vetme të përhershme një vlerëshe, të mbështetur nga një program i zëvendësimit të matësve.

### 3.2 Grupi me blloqe i tarifave të konsumatorëve shtëpiak

Gjersa tarifata e propozuara me pakicë paraqesin një hap të rëndësishëm drejt niveleve të kostove reflektive, ZRrE-ja është e brengosur se rritjet e mëdha në tarifa për konsumatorët e vegjël shtëpiak do të krijojnë shqetësime lidhur me mundësinë (përballueshmërinë) e pagesës – veçmas në një afat të shkurtër, derisa buxhetet e konsumatorëve shtëpiak të përshtaten me çmimet e reja. Edhe pse skema e ndihmave për rastet sociale siguron disa lehtësime, kjo nuk i mbulon të gjithë konsumatorët shtëpiak me të hyra të ulëta, të cilët mund të goditen nga ky ndikim i pafavorshëm.

***Prandaj ZRrE-ja propozon të paraqesë një strukturë tarifore me tri blloqe për konsumatorët shtëpiak.*** Tri blloqet e propozuara të konsumit janë:

- <200kWh/muaj – paraqet përlllogaritjen e ZRrE-së për nevojat minimale të energjisë elektrike për konsumatorët të cilët nuk shfrytëzojnë energjinë elektrike për ngrohje, këta ngarkohen me tarifën më të ulët prej 70% të mesatares së tarifës së konsumatorëve shtëpiak. Tarifata mesatare për këta konsumatorë nuk duhet të rriten gjatë gjithë vitit.
- 200-600kWh/muaj – paraqet përlllogaritjen e ZRrE-së për nevojat e arsyeshme të konsumatorëve për energji elektrike të cilët shfrytëzojnë energjinë elektrike për ngrohje, këta ngarkohen me 90% të mesatares së tarifës së konsumatorëve shtëpiak. Tarifa mesatare për këta konsumatorë nuk duhet të rritet më shumë se 5% gjatë gjithë vitit.
- >600kWh/muaj – ngarkohen me tarifën më të lartë për të mbuluar çfarëdo mungese në të hyra ndërmjet atyre të mbuluara sipas tarifave me pakicë të propozuara nga KEK Sh.A dhe atyre të mbuluara sipas dy blloqeve të para të propozuara nga ZRrE-ja.

Sipas kësaj strukture, konsumatorët e vegjël shtëpiak do të vazhdojnë të përfitojnë prej ndër-subvencionimit nga konsumatorët më të mëdhenj shtëpiak, siç është edhe momentalisht. Ndryshimet që rezultojnë në tarifata mesatare të gjithë vitit tregohen në tabelën 3. Kjo ilustron ndryshimin rezultues të tarifës mesatare të konsumatorëve shtëpiak me nivele të ndryshme të konsumit, me supozimin se tarifata e reja me pakicë do të hyjnë në fuqi që nga data 1 janar 2007, për krahasim me tabelën 2. Për shembull, po të ishin zbatuar tarifata e reja për tërë vitin 2007 (duke filluar nga data 1 janar 2007) fatura e tyre do të mbetej e pandryshuar<sup>2</sup>.

Edhe pse ky propozim e lehtëson brengën e ZRrE-së për t'iu shmangur rritjes së tepruar të çmimit për konsumatorët e vegjël, duhet të përmendet se kjo gjithashtu rezulton në shmangien e tarifave të konsumatorëve shtëpiak prej niveleve të kostos (reale) reflektive. Kjo duhet të rregullohet përmes përshtatjeve të ardhshme të tarifave me pakicë në drejtim të niveleve të kostos (reale) reflektive.

---

<sup>2</sup> Rritjet aktuale do të jenë pak më të ulëta se ato të treguara, pasi që tarifata e reja nuk do të hyjnë në fuqi gjerë më 1 prill 2007. Ky rezultat vjen sepse tarifata e reja paraqesin një ribalancim ndërmjet sezonave, me tarifata e dimrit për konsumatorë shtëpiak që rriten më shumë se ato të verës. Si rezultat i hyrjes në fuqi të tarifave të reja që nga data 1 prill 2007, në tre muajt e parë të vitit 2007 konsumatorët shtëpiak paguan tarifa ekzistuese më të ulëta dhe pastaj për gjashtë muajt e ardhshëm paguan tarifa më të ulëta të reja

**Tabela 3: Krahasimi në mesatare i tarifave të konsumatorëve shtëpiak me pakicë sipas propozimit me tri blloqe të ZRrE-së**

*Supozimi se tarifat e reja aplikohen për tërë vitin, për krahasim me tabelën 2*

0.4kV Konsumatori shtëpiak (tarifa 2-vlerëshe)		Konsumimi mujo kWh	Tarifat e tanishme		Kërkesa e KEK Sh.A (Viti i plotë)		
			Fatura vjetore €	Çmimi mesatar €/kWh	Fatura vjetore €	Çmimi mesatar €/kWh	Ndryshimi
0.4 kV Konsumatori shtëpiak	Nevojat minimale (pa ngrohje)	200	93	3.85	93	3.86	0.00%
	Nevojat minimale (me ngrohje)	600	278	3.85	292	4.05	5.10%
	Konsumator mesatar	1,000	509	4.24	652	5.44	28.20%
	Konsumator i madh	2,000	1,202	5.01	1,554	6.47	29.30%

## 4 Tarifat me pakicë të propozuara nga ZRrE-ja

Tarifat përfundimtare me pakicë, siç janë propozuar nga ZRrE-ja, shihen më poshtë në tabelën 4.

**Tabela 4: Tarifat me pakicë të KEK Sh.A të propozuara nga ZRrE-ja**

Aplikacioni i KEK Sh.A për tarifa me pakicë (me blloqe)  
Modifikuar nga ZRrE-ja më 8 mars 2007

Grupi Tarifor	Niveli i tensionit të furnizimit	Elementet tarifore	Njësia	Koha gjatë ditës (a)	Kërkesa e KEK Sh.A			
					Sezona e lartë	Sezona ulët	Sezona e lartë	Sezona ulët
					1 tetor - 31 mars	1 prill - 30 shtator	1 tetor - 31 mars	1 prill - 30 shtator
0	110kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit				34.00	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		1,150.00	895.00	519	519
		Energjia aktive (P), prej të cilës:	€/kWh	Tarifa e lartë	2.68	2.11	6.03	1.78
			€/kWh	Tarifa e ulët	1.34	1.09	2.5	1.47
		Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		1.41	1.15		
1	35kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit				30.00	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		1,278.00	959.00	540.00	540.00
		Energjia aktive (P), prej të cilës:	€/kWh	Tarifa e lartë	3.20	2.56	6.30	2.73
			€/kWh	Tarifa e ulët	1.60	1.28	3.33	2.47
		Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		1.28	0.96	0.04	0.04
2	10kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit				34.00	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		1,278.00	959.00	466.00	466.00
		Energjia aktive (P), prej të cilës:	€/kWh	Tarifa e lartë	3.52	2.81	7.07	3.15
			€/kWh	Tarifa e ulët	1.76	1.41	3.81	2.87
		Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		1.28	0.96	0.32	0.32
3	0.4kV Kategoria I (konsumatorët me shpenzim të energjisë reaktive)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit				29.00	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		852.00	631.00		
		Energjia aktive (P), prej të cilës:	€/kWh	Tarifa e lartë	5.11	3.83	9.83	5.40
			€/kWh	Tarifa e ulët	2.56	1.92	6.15	5.08
		Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		1.28	0.96	1.53	1.53
4	0.4kV Kategoria II	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit				34.00	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		253.00	189.00		
		Energjia aktive (P)	€/kWh	Tarifa e vetme	7.57	5.68	9.73	6.23
		Energjia aktive (P), prej të cilës:	€/kWh	Tarifa e lartë	9.47	6.94	11.05	6.35
			€/kWh	Tarifa e ulët	5.05	3.79	7.14	6.01
5	0.4kV matësi 2-tarifor (2-vlerësh) shtëpiak (c)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit				20.00	
		Fuqia e angazhuar prej të cilës: b)						
		<800 kWh/muaj			144.00	115.00		
		>800 kWh/muaj			192.00	144.00		
		Energjia aktive (P), për konsum:						
		<200kWh/muaj (Blloku i parë) prej të cilit:	€/kWh	Tarifa e lartë	4.80	3.83	3.47	2.49
			€/kWh	Tarifa e ulët	2.40	1.92	3.47	2.49
		200-600 kWh/muaj (Blloku i dytë) prej të cilit:	€/kWh	Tarifa e lartë	4.80	3.83	4.76	3.42
	€/kWh	Tarifa e ulët	2.40	1.92	4.76	3.42		
>600 kWh/muaj (Blloku i tretë) prej të cilit:	€/kWh	Tarifa e lartë	5.11	3.83	8.43	6.06		
			€/kWh	Tarifa e ulët	2.56	1.92	8.43	6.06
6	0.4kV matësi 1-tarifor (1-vlerësh) shtëpiak (c)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit				20.00	
		Fuqia e angazhuar prej të cilës: b)						
		<800 kWh/muaj			144.00	115.00		
		>800 kWh/muaj			192.00	144.00		
		Energjia aktive (P), për konsum:						
		<200kWh/muaj (Blloku i parë) prej të cilit:	€/kWh	Tarifa e vetme	3.99	3.20	3.47	2.49
200-600 kWh/muaj (Blloku i dytë) prej të cilit:	€/kWh	Tarifa e vetme	3.99	3.20	4.76	3.42		
>600 kWh/muaj (Blloku i tretë) prej të cilit:	€/kWh	Tarifa e vetme	6.39	4.80	8.43	6.06		
7	0.4kV (shtëpiak pa matës)	Konsumi i vlerësuar <400kWh/muaj	€/konsumator/muaj		20.00	20.00	23.00	
		Konsumi i vlerësuar 400-800kWh/muaj	€/konsumator/muaj		36.00	36.00	42.00	
		Konsumi i vlerësuar >800kWh/muaj	€/konsumator/muaj		61.00	61.00	71.00	
8	Ndriqimi publik	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit				34.00	
		Energjia aktive (P)	€/kWh	Tarifa e vetme	8.21	6.31	7.82	7.82

a Tarifa e lartë aplikohet prej 07:00-22:00 (e Hënë-e Shtunë) gjatë sezonës së lartë dhe prej 08:00-23:00 (e Hënë- e Shtunë) gjatë sezonës së ulët

b Aty ku nuk është i instaluar maksigrufi, kërkesa ekzistuese llogaritet si volumi i energjisë së konsumuar sipas tarifës së lartë pjesëtar me 100

c Konsumatorët e regjistruar si raste sociale ngarkohen me normë zero